



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 126

31 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

| | Faqe |
|--|---|
| Vendim i KM nr. 588, datë 30.5.2013 | Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, shtesa e dytë e marrëveshjes me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe San Leon Durrësi B.V., për bllokun “Durrësi” (në det), Shqipëri 5361 |
| Vendim i KM nr. 589, datë 17.7.2013 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar 5364 |
| Vendim i KM nr. 590, datë 17.7.2013 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 791, datë 14.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil”..... 5374 |
| Urdhër i KM nr. 87, datë 25.7.2013 | Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor..... 5375 |

VENDIM
Nr. 588, datë 30.5.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE, SHTESA E DYTË E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN) DHE SAN LEON DURRËSI B.V., PËR BLOKUN “DURRËSI” (NË DET), SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, shtesa e dytë e marrëveshjes me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe San Leon Durrësi B.V., për bllokun “Durrësi” (në det), Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJA HIDROKARBURE
SHTESA E DYTË

E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE DHE SAN LEON DURRËSI B.V. PËR BLOKUN “DURRËS” (NË DET) SHQIPËRI

Kjo marrëveshje hidrokarbure shtesë e dytë (në vijim “MHS” e dytë), lidhet ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të Republikës së Shqipërisë (në vijim “AKBN”) dhe San Leon Durrësi B.V. (në vijim “San Leon”) është bërë dhe pranuar në datën 16.7.2013.

Në vijim, San Leon do të referohet si “Kontraktori”, gjithashtu, AKBN-ja dhe Kontraktori në vijim do të referohen si “Palët”.

Duke pasur parasysh se, më 27 maj 2004 është lidhur kontrata me ndarje prodhimi ndërmjet AKBN-së (ish-NPA) dhe Kontraktorit (ish-OMV-ja (shqiptare) Adriatic Sea Exploration GmbH dhe Lundin Netherlands BV), e cila është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 562, me datë 27 gusht 2004 dhe hyn në fuqi më 27 gusht 2004 (në vijim KNP); dhe se më 7 shtator 2010 është lidhur marrëveshja hidrokarbure shtesë ndërmjet AKBN-së dhe Kontraktorit (ish-Island International Exploration B.V. dhe Beach Energy Limited), që ka ndryshuar KNP-në, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, me datë 12 janar 2011 dhe hyn në fuqi më 31 janar 2011 (në vijim “MHS”); dhe

Duke pasur parasysh: i) letrën e AKBN-së me datë 27 maj 2004 dhe nr. prot. 596, që miraton transferimin e 50% të interesave në bllokun e Durrësit (në det) nga OMV-ja (shqiptare)



Adriatic Sea Exploration GmbH tek Island Rockall JV Limited; ii) njoftimin e transferimit me datë 28 shtator 2007 për transferimin e 50% të interesave në bllokun e Durrësit (në det) nga Island Rockall JV Limited tek Island International Exploration BV; iii) njoftimin e transferimit me datë 31 tetor 2007 për transferimin e 50% të interesave në bllokun e Durrësit (në det) nga Lundin Netherland BV tek Island International Exploration BV; iv) letrën e AKBN-së me datë 11 mars 2008 dhe nr. prot. 525, që miraton transferimin e 25% të interesave në bllokun e Durrësit (në det) nga Island International Exploration BV (aktualisht San Leon Durrësi B.V., pas ndryshimit të emrit më 13 shtator 2011) te Beach Petroleum Limited, që sipas njoftimit me datë 11 janar 2010 ndryshon emrin në Beach Energy Limited; dhe v) letrën e AKBN-së me datë 16 shkurt 2012 dhe nr. prot. 1150, që miraton transferimin e 25% të interesave në bllokun e Durrësit (në det) nga Beach Energy Limited te San Leon.

Duke pasur parasysh se Kontraktori ka të drejtën ekskluzive të kryejë operacione hidrokarbure në Zonën e Kontratës; dhe

Duke pasur parasysh se Palët pranojnë se prodhimi, përpunimi dhe depozitimi i naftës kërkon investime të konsiderueshme; dhe

Duke pasur parasysh se Palët pranojnë që miratimi i investimeve për zbulimin e naftës i nënshtrohet marrëveshjes unanime të Palëve; dhe, në veçanti, sipas nenit 31.10 të KNP-së, asnjë ndryshim i KNP-së nuk do të jetë efektiv, nëse nuk bëhet me shkrim dhe nuk firmoset nga Palët.

Për këto arsye, duke marrë parasysh kushtet paraprake dhe marrëveshjet reciproke, Palët bien dakord për të ndryshuar disa nga dispozitat e parashikuara në KNP (e ndryshuar nga MHS) për kërkimin dhe prodhimin e naftës në bllokun e “Durrësit” (në det) në Republikën e Shqipërisë.

1. Qëllimi

MHS-ja e dytë së bashku me KNP-në (e ndryshuar nga MHS) ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe afateve që rregullojnë operacionet hidrokarbure në Zonën e Kontratës ose në çdo pjesë tjetër që zotërohet në bazë të KNP-së dhe të drejtat e detyrimit e parashikuara për këtë qëllim në vijim. MHS-ja e dytë do të konsiderohet si pjesë plotësuese e KNP-së (ndryshuar nga MHS).

Palët pranojnë dhe bien dakord që të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me operacionet e hidrokarbureve në Zonën e Kontratës do të rregullohen sipas dispozitave të KNP-së (ndryshuar nga MHS) dhe MHS-së së dytë.

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga MHS-ja e dytë, çdo fjalë me shkronja të mëdha do të ketë të njëjtin kuptim si në KNP-në (e ndryshuar nga MHS). Të gjitha dispozitat e KNP-së dhe MHS-së, sikurse janë ndryshuar nga kjo MHS e dytë, do të mbeten tërësisht në fuqi me efekte të plota dhe në rast konflikti të mundshëm midis KNP-së (së ndryshuar nga MHS) dhe dispozitave të MHS-së së dytë, këto të fundit do të mbizotërojnë kundrejt atyre të KNP-së (së ndryshuar nga MHS).

Nenet e MHS-së së dytë i referohen tekstit të KNP-së (së ndryshuar nga MHS).

2. Neni 1 - Përkufizimet

Palët bien dakord për shfuqizimin dhe zëvendësimin e dispozitave të KNP-së (së ndryshuar nga MHS) si më poshtë vijon.

Përkufizimi “Kontraktor” i parashikuar në paragrafin 1.18 zëvendësohet me përkufizimin në vijim:

“Kontraktor” do të thotë San Leon, pasardhësit e tij ose përfituesit e interesave përkatëse të miratuar në përputhje me nenit 21.”

Përkufizimi “Periudha e Dytë e Kërkimeve” e parashikuar në paragrafin 1.48, zëvendësohet me përkufizimin në vijim: “Periudha e Dytë e Kërkimeve” do të thotë një periudhë prej 2 (dy) vitesh kontraktore nga data e hyrjes në fuqi të MHS-së së dytë, së bashku me çdo zgjatje afati të kësaj periudhe, sikurse parashikuar në këtë kontratë.”

Përkufizimi “Periudha e Tretë e Kërkimeve” e parashikuar në nenin 1.49, shfuqizohet.

3. Neni 2 - Qëllimi i marrëveshjes, pjesëmarrja

Paragrafi 2.9 KNP (ndryshuar nga MHS) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

“Interesat pjesëmarrëse të shoqërive janë si më poshtë:

San Leon Durrësi B.V. 100%.”.

4. Neni 3 - Afatet

Shtohet paragrafi 3.9 në vijim:

“Palët bien dakord që periudha midis 30 janarit 2012 dhe datës së hyrjes në fuqi të MHS-së së dytë do të konsiderohet si një “Periudhë Pezullimi” dhe të gjitha detyrimet e parashikuara nga KNP-ja (e ndryshuar nga MHS) për këtë periudhë konsiderohen të pezulluara.”

5. Neni 4 - Heqja dorë

Paragrafi 4.1 i KNP-së (i ndryshuar nga MHS) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

“Nëse Kontraktori zgjedh të hyjë në Periudhën e Dytë të Kërkimit, Kontraktori në mbarim të Periudhës së Parë të Kërkimit do të heqë dorë nga 20% e Zonës së Kontratës.”

6. Neni 5 - Kryerja e operacioneve

Paragrafi 5.2.2 i KNP-së (i ndryshuar nga MHS) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

“San Leon Durrësi B.V. përcaktohet si operator.”.

7. Neni 6 - Programet e punës, buxheti dhe detyrimet e punës

Neni 6.7 (ii) KNP (i ndryshuar nga MHS) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

“Periudha e Dytë e Kërkimit: shpim i 2 (dy) puseve”.

Paragrafi 6.7 (iii) i KNP-së (ndryshuar nga MHS) shfuqizohet.

8. Të ndryshme

Nenet 23 dhe 24 të KNP-së do të aplikohen ndaj MHS-së së dytë. MHS-ja e dytë do të hyjë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë të vendimit të miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Për më tepër qartësi, Palët bien dakord që përkufizimi “Periudha e Tretë Kërkimi” dhe çfarëdo detyrimi dhe/pse sipërmarrje që i referohet apo lidhet me “Periudhën e Tretë të Kërkimit”, e cila përmendet në KNP (e ndryshuar nga MHS) shfuqizohet, me përjashtim të rasteve kur në mënyrë të shprehur parashikohet ndryshe në MHS-në e dytë.

Në dëshmi këtu, Palët kanë ekzekutuar këtë marrëveshje hidrokarbure shtesë që do të hyjë në fuqi në datën kur vendimi i Këshillit të Ministrave aprovon hyrjen e saj në fuqi.

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Florjon Mima

SAN LEON DURRËSI B.V.
Ervin Lula

Datë 16.7.2013



VENDIM
Nr. 589, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE, NË KRYEMINISTRIT, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, GJYKATËN E LARTË, DISA
INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të pikës 1/2 shtohet emërtesa “Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

b) Në pikën 1/3/a, emërtesat “Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, shfuqizohen.

c) Në pikën 1/3/b shtohet emërtesa “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”.

ç) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Shkronja “b” e pikës 2, riformulohet si më poshtë vijon:

“b) Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) e lidhjes nr. 1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.”.

dh) Në fund të pikës 4/1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Zbatimi i kësaj shtese, i miratuar për nëpunësit aktualë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.”.

e) Paragrafi i parë i pikës 5 riformulohet si më poshtë vijon:

“-“Specialist arkivi”, në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, si dhe në pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit;”.

ë) Pika 6 riformulohet si më poshtë vijon:

“6. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin, prefektin, nënprefektin, nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës dhe prefekturë janë si vijon:

- Zëvendësministër 140000 lekë;
- Drejtor i kabinetit të Presidentit, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, të Prokurorit të Përgjithshëm, të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a.
- Këshilltari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, këshilltari për protokollin i Kryeministrit, këshilltari për protokollin i Presidentit, zëdhënësi i Presidentit, drejtori i kabinetit të Zëvendëskryeministrit, drejtori i kabinetit të Avokatit të Popullit, Koordinatori Kombëtar për Urdhrat Profesionalë, pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit barazohen në pagë me Zëvendësministrin;
- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, i kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Avokatit të Popullit, ndihmësi i Presidentit, i Kryeministrit dhe i Kryetarit të Kuvendit dhe këshilltari i Zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b.
- Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit dhe i nënkryetarit të Kuvendit, drejtori i kabinetit të ministrit dhe drejtorët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.
- Këshilltari i ministrit, zëdhënësi i ministrit dhe këshilltarët dhe zëdhënësi i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.
- Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.
- Prefekti i Qarkut të Tiranës 118500 lekë.
- Prefekti i qarqeve të tjera 110500 lekë.
- Nënprefekti i nënprefekturave Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë 95000 lekë.
- Nënprefekti i nënprefekturave Krushjë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 88000 lekë.
- Nënprefekti i nënprefekturave Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 83800 lekë.
- Këshilltari i Prefektit të Qarkut të Tiranës 66500 lekë.
- Zëdhënësi i Prefektit të Qarkut të Tiranës 56500 lekë.
- Sekretari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Prokurorit të Përgjithshëm, i Zëvendëskryeministrit, i nënkryetarit të Kuvendit dhe i Avokatit të Popullit 70000 lekë.
- Sekretari i ministrit, sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit, sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, sekretari i organit kolegjal drejtues, sekretar në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi 59000 lekë.



Shtesa për vjetërsi në punë për të gjitha pozicionet sekretar jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë në muaj. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë për femrat dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga titullari i institucionit përkatës.

f) Lidhja nr. 5/2, që përmendet në pikën 9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

g) Lidhja nr. 6, që përmendet në pikën 10, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

gj) Pika 10/1 shfuqizohet.

h) Lidhja nr. 6/8, që përmendet në pikën 10/8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

i) Lidhja nr. 6/9, që përmendet në pikën 10/9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

j) Lidhja nr. 7/1 (pjesa I dhe II), që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

k) Lidhja nr. 7/4, që përmendet në pikën 11/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

l) Lidhja nr. 8, që përmendet në pikën 12, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ll) Pika 13/1 shfuqizohet.

m) Lidhja nr. 9/4, që përmendet në pikën 13/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi për vitin 2013:

- Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë. Vlerat e klasave/kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni për periudhën përpara datës 15 korrik 2013 të jenë sipas vendimit nr. 524, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave.

- Për të gjitha parashikimet e tjera të fillojnë nga data 15 korrik 2013.

3. Efektet financiare të këtij vendimi për vitin 2013:

- Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për periudhën nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë deri në datën 15 korrik 2013, të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë institucion për vitin 2013.

- Për të gjitha parashikimet e tjera të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË/NËPUNËSIT NË TË GJITHA
INSTITUCIONET PJESË E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI

| Klasa | Kategoritë | PAGA MUJORE | | | |
|-------|------------|---------------------------------|--|--|-----------------------------------|
| | | Paga individuale (paga bazë) | | | Shtesa e pozicionit |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit (PG) lekë | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) në përqindje | Shtesa për kualifikim (SHK) lekë | Shtesa për pozicion (SHP) lekë |
| I | I-a | | 2% | | 129.000 |
| | I-b | | 2% | | 118.000 |
| II | II-a | | 2% | | 107.800 |
| | II-b | | 2% | | 91.700 |
| III | III-a | | 2% | 0 | 74.400 |
| | III-a/1 | | 2% | 0 | 65.200 |
| | III-b | | 2% | 0 | 57.000 |
| IV | IV-a | | 2% | 0 | 45.800 |
| | IV-b | | 2% | 0 | 35.500 |
| | IV-c | | 2% | 0 | 27.500 |

Lidhja nr. 5/2

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT KËRKIMORË E SHKENCORË
NË AKADEMINË E SHKENCAVE

| | Emërtimi | Paga në lekë |
|----|--|--------------|
| 1. | Kryetar i Akademisë së Shkencave | 174.760 |
| 2. | Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave | 140.000 |
| 3. | Akademik | 125.000 |
| 4. | Akademik i Asociuar Profesor | 110.000 |
| 5. | Profesor i Asociuar | 96.000 |

SHTESAT NË PËRQINDJE MBI PAGËN MUJORE PËR FUNKSIONE DREJTUESE
TË PUNONJËSVE SI MË SIPËR

| Pozicioni | Shtesa në lekë |
|---|----------------|
| Kryetar seksioni. Sekretar shkencor i seksionit | 12000 |



Lidhja nr. 6

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT
“SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUCIONET QENDRORE
TË PËRCAKTUARA SIPAS PIKËS 1/3/A TË KËTIJ VENDIMI**

| Pozicioni | Kategoria | Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit |
|---|------------------|--|
| Titullar i institucionit | II-a | 1 |
| Zv/titullar i institucionit; Inspektor në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian; Drejtor drejtorie në Agjencinë Kombëtare të Provimeve; Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike | II-b | 1 |
| Drejtor drejtorie; Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve; Kapiteni i porteve | III-a | 1 |
| Përgjegjës sektori; Kapiteni i Portit | III-a/1 | 1 |
| Përgjegjës sektori; Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike | III-b | 1 |
| Inspektor; Ekspert në Drejtorinë e Policisë Shkencore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit | III-b | 1 ose 2 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 |

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE
TË SISTEMIT DOGANOR

| Klasifikim i doganor | POZICIONI | Kategoria | Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit | SHITESA E POZICIONIT | |
|-------------------------|---|-----------|--|--|---------------------------------|
| | | | | Shtesa e pozicionit (SHP) | Shtesa për kushte pune |
| | Titullar i institucionit | II-a | 1 | | 20000 |
| | Zv/drejtor i përgjithshëm | II-b | 1 | | 15000 |
| A | Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kakavijë, Rinas | III-a | 1 | | 15000 |
| B | Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës | III-a/1 | 1 | | 14000 |
| C1 | Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabande. Specialist. Administrator rrjeti | III-b | 1 ose 2 | | 14000 |
| | Financier në degë doganore , përkthyes, koordinator në DOH, specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare | | 1 ose 2 | | 10000 |
| C2 | Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator. Llogaritar | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | | 10000 |
| C3 | Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretar. Arkivist | | | 37000 | 5000 |
| D1 | Magaziniar. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik | | | 32000 | 1500 |
| D2 | Punëtor mirëmbajtës | | | Klasa IV (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e | |



| | | | | | | |
|-----------|-------------------|--|--|--|---|--|
| | | | | | punonjësve mbështetës) | |
| D3 | Punonjës pastrimi | | | | Klasa I (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës) | |

Lidhja nr. 6/9

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

| | | | | PAGA MUJORE | | | |
|------------|---------|---------|--|-----------------------------------|-----------------------------|---------------------------|------------------------|
| | | | | PAGA INDIVIDUALE | | SHTESA E POZICIONIT | |
| | | | EMËRTIMI | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) | Shtesa për kushte pune |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | II-a | 1 | Drejtor i përgjithshëm | 2% | | | 20000 |
| | II-b | 1 | Zv/drejtor i përgjithshëm | 2% | | | 15000 |
| A | III-a | 1 | Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale | 2% | 0 | | 15000 |
| B | III-a/1 | 1 | Përgjegjës/shef sektori në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale | 2% | 0 | | 14000 |
| | | | Përgjegjës/shef sektori/ zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. | 2% | 0 | | 12000 |
| | III-b | 1 ose 2 | Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve | | | | |
| C.1 | III-b | 1 ose 2 | Përgjegjës zyre në Task Forcë | 2% | 0 | | 17000 |
| C.2 | IV-a | 1 ose 2 | Inspektor i dytë. Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor | 2% | 0 | | 12000 |

| | | | | | | | |
|------------|------|---------------------------|--|----|---|--|-------|
| | | ose 3 | hetimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale | | | | |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi/ specialist në drejtoritë rajonale | 2% | 0 | | 10000 |
| C.3 | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | Specialist | 2% | 0 | | 5000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | Sekretar në drejtorinë e përgjithshme | 2% | 0 | | 5000 |
| D.1 | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | Sekretar në drejtoritë rajonale | 2% | 0 | | 5000 |

Lidhja nr. 7/1

NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIN KOMBËTAR TË KOMEDISË

I. Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operës dhe Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor

| Nr. | Pozicioni | Paga |
|------------|---|-------------|
| 1 | Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaestër Baletmaestër Aktor i parë Solist II (spala sektori) | 79.200 lekë |
| 2 | Asistent dirigjent Asistent regjisor Aktor i dytë Orkestrat i kategorisë së parë | 71.000 lekë |
| 3 | Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë | 59.800 lekë |
| 4 | Aktor i tretë | 58.300 lekë |



| | | |
|---|---|-------------|
| 5 | Orkestrat i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Skenograf i kategorisë së dytë | 49.500 lekë |
|---|---|-------------|

II. Për Drejtorinë Artistike të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar

| Nr. | Pozicioni | Paga |
|-----|--|-------------|
| 1 | Dirigjent Regjisor Drejtues artistik | 71.000 lekë |
| 2 | Solist i parë Orkestrat i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë Akrobat i kategorisë së parë Mjeshtër i studios së cirkut Mjeshtër profili i numrave të cirkut | 59.800 lekë |
| 3 | Solist i dytë Orkestrat i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë Akrobat i kategorisë së dytë | 49.500 lekë |

Lidhja nr. 7/4

NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË QENDRËN E KULTURËS,
MEDIAS DHE BOTIMEVE TË MBROJTJES

| Nr. | Pozicioni | Paga |
|-----|---------------------------|-------------|
| 1 | Udhëheqës artistik | 79.200 lekë |
| 2 | Dirigjent Regjisor | 71.000 lekë |
| 3 | Instrumentist Vokalist | 59.800 lekë |

Lidhja nr. 8

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR
EMËRTE SAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUCIONET
QEDNRORE TË PËRCAKTUARA SIPAS PIKËS 1/3/C TË KËTIJ VENDIMI**

| Pozicioni | Kategoria | Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit |
|--|------------------|--|
| Titullar i institucionit | III-a | 1 |
| Drejtor drejtorie Sekretar i përgjithshëm në federatat sportive | III-b | 1 |
| Përgjegjës sektori | IV-a | 1 |
| Inspektor | IV-a | 1 ose 2 |
| Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 |
| Restaurator Lektor Arkivist/katalogist Historian | IV-c | 1 ose 2 ose 3 |

Lidhja nr. 9/4

**KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË
PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTE SAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR
INSTITUCIONI” NË DREJTORITË E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE
INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE INFORMALE**

| Pozicioni | Kategoria | Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit | Shtesa për kushte pune |
|---|------------------|--|-------------------------------|
| Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 1, Durrës, Lezhë, Vlorë 1, Shkodër | III-a/1 | 1 | 16.500 |
| Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t: Tiranë 2 – Kamëz, Tiranë 2 – Paskuqan, Tiranë 2 – Farkë, Tiranë 2 – Vorë, Tiranë 3, Elbasan 1, Berat, Korçë, Fier 1, Kavajë, Vlorë 2, Elbasan 2, Fier 2, Sarandë, Lushnjë, Krujë, Pogradec, Gjiroka stër, Dibër, Kukës | III-b | 1 | 16.500 |
| Përgjegjës sektori | IV-a | 1 | 10.000 |
| Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 10.000 |



VENDIM
Nr. 590, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 791, DATË 14.11.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË ORGANIKËS, SI DHE TË
STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË AUTORITETIT
TË AVIACIONIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 10 233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 791, datë 14.11.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Lidhja nr. 3, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjes nr. 3, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 3

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË
AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL**

| Pozicioni | Kategoria | Paga individuale (paga bazë) | | | Shtesa e pozicionit | Shtesa për kushte pune |
|--|-----------|---------------------------------|--|------------------------------------|----------------------------------|---------------------------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) | |
| Titullar i institucionit | II-a | | 2% | | 107.800 | 15.000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit/drejtor | II-b | | 2% | | 91.700 | 15.000 |

| | | | | | | |
|----------------------|---------|--|----|---|--------|---|
| Drejtor drejtorie | II-b | | 2% | 0 | 91.700 | 0 |
| Përgjegjës sektori | III-a | | 2% | 0 | 74.400 | 0 |
| Përgjegjës sektori | III-a/1 | | 2% | 0 | 65.200 | 0 |
| Inspektor Specialist | III-b | | 2% | 0 | 57.000 | 0 |
| Specialist | IV-a | | 2% | 0 | 45.800 | 0 |

URDHËR

Nr. 87, datë 25.7.2013

PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Bordit për Informacionin Gjeohapësimor (BIG).
2. Bordi të kryesohet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë:
 - a) Këshilltarin e Kryeministrit për shoqërinë e informacionit.
 - b) Drejtorin e përgjithshëm të ASIG-ut.
 - c) Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
 - ç) Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.
 - d) Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë.
 - dh) Drejtorin e Institutit Gjeografik të Tiranës.
 - e) Drejtorin e Institutit të Statistikave.
 - ë) Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.
 - f) Drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale;
 - g) Një përfaqësues të Ministrisë së Financave;
 - gj) Një përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - h) Një përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - i) Një përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - j) Një përfaqësues nga Komisioni Qeveritar i Tokës;
 - k) Një përfaqësues i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
 - l) Shefin e Departamentit të Gjeodezisë të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - ll) Një përfaqësues të Shoqatës së Bashkive;
 - m) Kryetarin e Shoqatës së Inxhinierëve Gjeodetë, të licencuar.
3. Fusha e veprimtarisë së bordit të jetë këshillimi dhe formulimi i mendimeve e propozimeve lidhur me:
 - a) zhvillimin e politikës kombëtare për infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore;
 - b) përmirësimin dhe plotësimin e legjislacionit në fuqi për infrastrukturën kombëtare të të dhënave gjeohapësinore;



- c) zhvillimin dhe përmirësimin e teknologjisë në fushën e informacionit gjeohapësinor;
 - ç) përcaktimin e temave të tjera sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - d) vendimet e ASIG-ut për mbledhjen, përpunimin dhe/ose përditësimin e të dhënave gjeohapësinore nga autoritetet publike sipas temave përkatëse;
 - dh) përcaktimin e standardeve shtetërore dhe rregullave uniforme për krijimin e sistemeve të informacionit gjeohapësinor, për secilën temë;
 - e) rregullat e hartuara nga ASIG-u për krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe metadateve;
 - ë) rregullat e hartuara nga ASIG-u për realizimin e ndërveprueshmërisë;
 - f) përcaktimin e kushteve që lidhen me krijimin e GIS kombëtar;
 - g) përcaktimin e rregullave për aksesin dhe shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor nga subjektet publike dhe private;
 - gj) nismat e institucioneve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor;
 - h) përcaktimin e rregullave teknike dhe të administrimit të Gjeoportail-it;
 - i) çdo çështje tjetër që lidhet me infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore.
4. Bordi për Informacionin Gjeohapësinor, në varësi të tematikës që shqyrton, fton në mbledhjet e tij ekspertë të fushave të ndryshme.
5. Bordi për Informacionin Gjeohapësinor e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
6. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Bordi për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE E BRENDSHME
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG).

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “BIG” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 3 i ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

b) Ligji për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor është ligji nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

c) “Autoriteti publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 2 i ligjit nr. 72, datë 28.6.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

ç) “ASIG” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 1 i ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

d) “Ministri” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 20 i ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 **Mbledhja e BIG-ut**

1. BIG-u diskuton dhe merr vendimet e nevojshme nëpërmjet mbledhjeve të tij. Mbledhja e BIG-ut është takimi zyrtar i anëtarëve të tij.

2. BIG-u mbledhet si rregull në mbledhje të zakonshme jo më pak se 4 herë në vit. Në raste të veçanta, mbledhja e BIG-ut thirret jashtë radhe, me kërkesën e motivuar të kryetarit të BIG-ut ose të 5 anëtarëve të tij.

3. Njoftimi për vendin, kohën e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialet që do të shqyrtohen, u dërgohen anëtarëve të BIG-ut të paktën gjashtë ditë përpara datës së mbledhjes.

4. Mbledhjet e BIG-ut thirren dhe drejtohen nga kryetari i BIG-ut, dhe në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të autorizuar prej tij.

5. Mbledhjet e BIG-ut zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se 2/3 e anëtarëve. Në mbledhje marrin pjesë kryetari, anëtarët dhe të ftuarit sipas rastit dhe sekretariati teknik i BIG-ut.

6. Mbledhjen e BIG-ut e hap dhe e drejton kryetari. Në fund të mbledhjes, kryetari deklaron mbylljen e saj dhe kur një ose disa çështje të rendit të ditës nuk arrijnë të shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, ai vendos vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër.

7. Kryetari i BIG-ut ushtron këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) thërret dhe drejton mbledhjet e BIG-ut;

b) cakton rendin e ditës së mbledhjeve të BIG-ut në bashkëpunim me drejtorin e ASIG-ut;

c) kujdeset që drejtimi i BIG-ut të jetë në përputhje me ligjin nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4 **Përgatitja e materialeve dhe mënyra e paraqitjes së tyre**

Përgatitja e materialeve, që do të merren në shqyrtim në mbledhjen e BIG-ut, do të bëhet nga sekretariati teknik i BIG-ut në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 16 të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

Neni 5 **Procedura e marrjes së vendimit për mendimin e shprehur**

1. BIG-u shpreh mendim për materialet e paraqitura, kur në mbledhjen e tij janë të pranishëm më shumë se 2/3 e anëtarëve.

2. Mendimi i shprehur duhet të mbështetet nga shumica e thjeshtë e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit të mbledhjes është përcaktuese.



3. Votimi bëhet me gojë ose me ngritje dore. Gjatë votimit nuk lejohen abstenime.

4. Në rastin kur një anëtar i BIG-ut ose pjesëtarë të familjes së tij kanë lidhje interesash të drejtpërdrejta ose të tërthorta me çështjen që trajtohet në mbledhje, ai detyrohet të deklarojë interesat e tij që në fillim të diskutimit dhe nuk merr pjesë në votim.

5. Në raste të veçanta, urgjente dhe tepër të rëndësishme, kryetari i BIG-ut mund të miratojë shprehjen e mendimit edhe pa u mbledhur BIG-u, por për këto raste, duhet të shprehin mendimin e tyre edhe minimumi 5 anëtarë të BIG-ut. Kryetari porosit marrjen e një vendimi qarkullues, i cili nënshkruhet më pas nga të gjithë anëtarët e BIG-ut që e miratojnë këtë vendim.

Neni 6

Dokumentimi i mbledhjeve

Dokumentimi i mbledhjeve të BIG-ut të bëhet nga sekretariati teknik i BIG-ut në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 16 të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

Neni 7

Dispozita të fundit

Vlerësimet dhe debatet që zhvillohen gjatë shqyrtimit të materialeve të paraqitura dhe marrjes së vendimeve në mbledhjet e BIG-ut janë konfidenciale.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 31.7.2013
Doli nga shtypi më 31.7.2013

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 22 lekë